



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE

**PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT
“BLERJE MATERIALE ELEKTRIKE”**

I mbajtur sot në datë 05.05.2026 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje materiale elektrike”**, me fondin limit **38 997 766.67** (*tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e shtatë*) **Lekë pa Tvsh.**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (*i ndryshuar*) parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsytet e mëposhtme:

Së pari, do të ishte shumë më efikase që kjo kontratë të realizohej nga një operator ekonomik pasi do të organizohej një rend i saktë i shpërndarjes së mallrave në kohë dhe sasi. Për këto shkaqe të parashtruara më sipër marrëveshja kuadër duhet të lidhet me një operator ekonomik. Si përfundim, me qëllim garantimin e furnizimit në afatet kohore të përcaktuara, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me llojin e mallrave, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të

prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Elfrida Lamaj _____
2. Rajnela Hoxha _____
3. Rezart Reçi _____